REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 31 176 Vendimit

31176

# V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 04.03.04 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane M. Vuure mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
- **Nikoll Kola**
per regjistrimin si person juridik te shoqerise " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. dhe:

KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi, z. **Nikoll Kola**, per regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k, me Dy ortake, zz. **Nikoll Kola dhe Ndrec Kola,** me administrator z. **Nikoll Kola**, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje me afat te pacaktuar mbi 10 vjet, me seli: Lagja Nr.17, Rruga "Stef Kaçulini", Durres, me objekt te veprimtarise ne fushen e:
- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
  Makinerive e paisjeve te ndryshme, mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro- sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- Pike servisi automjetesh, Lavazh.
- Hoteleri - turizmit. Bar - Kafe - Restorant.
- Transport mallrash te ndryshme brenda e jashte vendit.

Eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit **Nr.7638**, date 19.11.1992 dhe te Ligjit **Nr.7667** date 28.01.1993:

# V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k, me Dy ortake, zz. **Nikoll Kola** dhe **Ndrec Kola**, me administrator z. **Nikoll Kola** me kapital fillestar 100.000 leke, me kohe-zgjatje me afat te pacaktuar mbi 10 vjet, me seli: Lagja Nr.17, Rruga "Stef Kaçulini", Durres, me objekt te veprimtarise ne fushen e:

- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:

  Makinerive e paisjeve te ndryshme, mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro- sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- Pike servisi automjetesh, Lavazh.
- Hoteleri - turizmit. Bar - Kafe - Restorant.
- Transport mallrash te ndryshme brenda e jashte vendit.

Kunder Vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 31176/1 Vendimit

# VENDIM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 15/1/ 2007 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane M. Dogo mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi :
- **Nikoll Kola**
per depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. dhe :

## KONSTATOVA

Se me vendimin Nr. **31176** date 04.03.2004 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. me Dy ortake z. **Nikoll Kola** dhe z. **Ndrec Kola** dhe administrator z. **Nikoll Kola**.

Me vendimin Nr. **1** date 06.01.2007 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. eshte vendosur :
- Largimi nga shoqeria i ortakut z. **Ndrec Kola** duke ja shitur kuoten e tij te kapitalit ne masen 50 %, ortakut tjeter te shoqerise z. **Nikoll Kola**, qe eshte dakort ta bleje kete kapital, i cili mbetet ortak i vetem dhe administrator i shoqerise me 100 % te kuotave te kapitalit themeltar.
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.

Transferimi i kuotave eshte realizuar me kontraten e shitjes Nr. 116 Rep. dhe Nr. 14/1 Kol. date 06.01.2007.

Kerkesa eshte e drejte dhe si i tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.**7638**, date 19.11.1992, dhe te Ligjit Nr.**7667** date 28.01.1993:

# VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit Nr. **1** date 06.01.2007 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. ku eshte vendosur :

- Largimi nga shoqeria i ortakut z. **Ndrec Kola** duke ja shitur kuoten e tij te kapitalit ne masen 50 %, ortakut tjeter te shoqerise z. **Nikoll Kola**, qe eshte dakort ta bleje kete kapital, i cili mbetet ortak i vetem dhe administrator i shoqerise me 100 % te kuotave te kapitalit themeltar.
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.

▪ Depozitimin e kontrates se shitjes Nr. 116 Rep. dhe Nr. 14/1 Kol. date 06.01.2007.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise

GJYQTARE

31176

# URDHER REGJISTRIMI

1.

a. " VELLEZERIT KOLA " SHPK

b. Selia ne Lagjen nr. 17 rrug. Stef Aroulin

c. Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice import eksport te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, etj.

Kapitali fillestar 100.000 depozituar prane noterit me nr. 716 rep date 3.3.2004

Ortake jane dy z. Nikoll Kola 50 %
z.Ndrec Kola 50 %

Administrator Nikoll Kola banues ne Durres

Kohezgjatja mbi 10 vjet

Akti i themelimit 3 flete

Statuti 7 flete

Data e nenshkrimit 3.3.2004

Data e regjistrimit 09 3.2004

Gjyqtare
Blerina Muca

# AKT THEMELUES

## I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE " VELLLEZERIT KOLA " SH.P.K.

Mbeshtetur ne Ligjin **Nr.7512** date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", dhe te ligjit **Nr.7638** date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare",

1- **Nikoll Kola,** i biri i Gjonit, dtl. 15.05.1967, banues Lagja Nr.14, Shkozet, Durres.

2- **Ndrec Kola**, i biri i Gjonit, dtl. 03.03.1969, banues Lagja Nr.14, Shkozet, Durres.

krijojme shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar **"VELLLEZERIT KOLA ",** dhe me aktin themelues te saj si vijon:

### FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur **"VELLLEZERIT KOLA"** sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

### SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private **"VELLLEZERIT KOLA"** sh.p.k. do te jete: Lagja Nr.17, Rruga "Stef Kaçulini", Durres.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
  Makinerive e paisjeve te ndryshme, mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro- sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- Pike servisi automjetesh, Lavazh.

- Hoteleri - turizmit. Bar - Kafe - Restorant.
- Transport mallrash te ndryshme brenda e jashte vendit.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape objekte prodhimi e njesi sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k. do te jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise si vijon:

**Nikoll Kola** ... ... ... 50 %
**Ndrec Kola** ... ... ... 50 %

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kuotat e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruare dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z.**Nikoll Kola,** i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne proporcion me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar.

NENI 10

Ortaket themelues kane te drejte te emerojne edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne gjykaten e shkalles se pare Durres.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit **Nr.7638** date 19.11.1992 “Mbi krijimin e shoqerive tregetare”.

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private **“VELLEZERIT KOLA”** sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**“ VELLEZERIT KOLA ”** sh.p.k.

Nikoll Kola

Ndrec Kola

# STATUT

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " VELLEZERIT KOLA "

Ne baze te ligjit **Nr.7512** date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit" dhe te ligjit **Nr.7638** date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues:

1- **Nikoll Kola,** i biri i Gjonit, dtl. 15.05.1967, banues Lagja Nr.14, Shkozet, Durres.
2- **Ndrec Kola,** i biri i Gjonit, dtl. 03.03.1969, banues Lagja Nr.14, Shkozet, Durres. Kavajes, P.160, shk.1/19,

hartojme Statutin e shoqerise si me poshte:

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private "**VELLEZERIT KOLA**" sh.p.k. do te jete: Lagja Nr.17, Rruga "Stef Kaçulini", Durres.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar, mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:
- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
  Makinerive e paisjeve te ndryshme, mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro- sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.

- Pike servisi automjetesh, Lavazh.
- Hoteleri - turizmit. Bar - Kafe - Restorant.
- Transport mallrash te ndryshme brenda e jashte vendit.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k. do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise si vijon:

**Nikoll Kola** ……….. 50 %

**Ndrec Kola** ……… 50 %

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kuotat e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruare dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise.Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare.Kete te drejte ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos-ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te pa lujteshme etj, te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Kuotat e kapitalit fillestar jane te siguruara nga ortaket themelues te shoqerise dhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 9

Shoqeria tregetare **" VELLEZERIT KOLA "** sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregetare **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria tregetare " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj.

Ortaket themelues i shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

NENI 11

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton edhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

NENI 12

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcion me perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaket nuk mund te kaloje kuotat e percaktuara ne kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortaket do te behet vetem me vendim unanim te Asamblese se ortakeve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z . **Nikoll Kola,** i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

NENI 14

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve.
Administratoret.
Komisioni i revizionimit.

Vendimet qe mer Asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise.
Asambleja thirret sa here qe e shohin te aresyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programi e veprimtarise per vitin e ardheshem dhe ne mars per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

NENI 15

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme kur te jene pranuar unanimisht nga ortaket themelues te shoqerise.

NENI 16

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te Asamblese se ortakeve themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 17

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaket themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te pergjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortaket themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryej veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise

2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punonjes te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 19

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

## MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 20

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 21

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 22

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 23

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 24

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te

vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 25

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdorim ortakeve themelues te shoqerise. Fitimi i realizuar nga shoqeria do te ndahet ne mes te ortakeve te saj ne perputhje me kapitalet e investuara, por pa kaluar perqindjet e percaktuara ne kapitalin fillestar.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

## DISPOZITA TE VEÇANTA

NENI 26

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

## SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 27

Shndrrimi i shoqerise " **VELLEZERIT KOLA** " sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 28

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Likuidatori eshte pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakeve themelues te shoqerise qe te derdhin teresisht kuotat qe i takojne atyre.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 29

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaket themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 30

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k.

## ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**" VELLEZERIT KOLA "** sh.p.k.

Nik Kola

Ndrec Kola

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr ..712.. ...Rep
Nr ... ... ... ....Kol

Tirane me 3/03/ 2004

VERTETIM

Sot me dt. 3/03/ 2004 u paraqiten para meje zz. **Nikoll Kola** dhe **Ndrec Kola** madhore, te panjohur prej meje, per identitetin e te cileve u njoha nga dokumentet identifikuese me Nr. 1562732 dhe Nr. Z 0828900 (pasaporta) , te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruhet pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

# ***KERKESE***

**KERKUESI:** Nikoll Gjon KOLA i datelindjes 15.05.1967 banues ne Shkozet,Durres, Administrator i Shoqerise “Vellezerit KOLA” Sh.p.kDurres.

**OBJEKTI** : Depozitimin ne regjistrin tregetar te Vendimit Nr.1 date06.01.2007 te Ortakeve te Shoqerise "Vellezerit KOLA" Sh.p.k. Durres.

## GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR
## T I R A N E

Shoqeria “Vellezerit KOLA” Sh.p.k eshte regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 31176 date 04.03.2004.

Duke iu referuar aktit te themelimit te kesaj shoqerie, statutit dhe vendimit te Gjykates se sipercituar Shoqeria “Vellezerit KOLA”shpk rezulton te kete kapital fillestar prej 100,000 leke.

Ortaku i kesaj shoqerie Z. Ndrec Kola, me vendimin nr. 1 date 06.01.2007 vendosi te shese me kontrate para noterit 50% te kuotave te tij ne shoqerine “Vellezerit KOLA” shpk, ortakut tjeter Z. Nikoll KOLA i cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise.

Per sa me lart per çka eshte vendosur me vendimin nr.1 date 06.01.2007 te ortakeve te shoqerise “Vellezerit KOLA” Sh.p.k kerkoj nga Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane te pranoje kerkesen per te bere ndryshimet perkatese ne regjistrin tregetar sipas kritereve ligjore.

Durres, 06.01.2007

K E R K U E S I
**Nikoll KOLA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Notere Ines V.ALEKSI.
Nr.__117__ Rep

***V E R T E T I M***

Sot me date 06.01.2007(dymije e shtate), ne Zyren e ~~Noterise Durres~~ u paraqit personalisht para meje noteres **Ines ALEKSI**, administratori i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Vellezerit KOLA” sh.p.k. z. Nikoll KOLA, i biri i Gjon, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. Z1778701 i cili nenshkroi para meje Noteres ***kerkesen per regjistrim te ndryshimeve sipas vendimit nr 1 te Asamblese se ortakeve te shoqerise” Vellezerit KOLA” te dates06.01.2007 mbi shitjen e 50% te kuotave te shoqerise Z. Nikoll KOLA,*** dhe une noteri duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoj .

**N O T E R E**
**Ines V.ALEKSI**

**SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"VELLEZERIT KOLA"sh.p.k**

# V E N D I M Nr. 1
## I ORTAKEVE TE SHOQERISE"VELLEZERIT KOLA"sh.p.k.

Sot me date 06.01.2007 ne, ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k Ndrec Kola dhe Nikoll Kola

**V E N D O S E M:**

1. Ne baze te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" Z.Ndrec Kola do t'i shese z. Nikoll Kola 50% (pesedhjete perqind ) te kuotave te kapitalit te shoqerise **"VELLEZERIT KOLA"** sh.p.k.

Shitja do te behet me kontrate shitje para Noterit, kontrate e cila do t'i bashkangjitet ketij vendimi.

2.Se bashku me shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise se shitur, Z..Nikoll Kola pranon marrjen persiper ne masen 50% te te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria, ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore ne ushtrimin e veprimtarise se saj.

3.Me nenshkrimin e kontrates se shitjes behet ortak I vetem I shoqerise"VELLEZERIT KOLA" Z. Nikoll Kola me masen 100% .

**ORTAKET**
**e SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"VELLEZERIT KOLA" sh.p.k.**

**Ndrec Kola** Ndrec Kola

**Nikoll Kola** NIKOLL KOLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Notere Ines V.ALEKSI.
Nr. 115 Rep Nr 137/2 Kol

***VERTETIM***

Sot me date 06.01.2007, diten e shtune, ne Zyren e Noterise Durres u paraqit personalisht para meje noteres **Ines ALEKSI**, ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Vellezerit Kola" sh.p.k. z.Ndrec Kola i dt 03.04.1969 Z. Nikoll Kola i dt 15.05.1967, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar prej pas Z Z0828900 dhe Z1778701 te cilet nenshkruan para meje Noteres ***vendimin nr 1 te Asamblese se ortakeve te shoqerise" Vellezerit Kola" mbi shitjen e 50% te kuotave te shoqerise te Z. Ndrec Kola tek Z. Nikoll Kola,*** dhe une noteri duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoj .

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE
DURRES

**NOTERE**
**Ines V.ALEKSI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE DURRES**
**Noter Ines ALEKSI.**
**Nr.** 116 **Rep Nr.** 14/1 **Kol**

# KONTRATE SHITJE
## KUOTASH DHE KAPITALESH

Sot me date 06.01.2007(dymije e shtate), diten e shtune,ne Zyren e Noterise Durres para meje noteres **Ines ALEKSI** me adrese Rruga "A Goga", u paraqiten personalisht palet:

**SHITESI:**
**Ndrec Gjon KOLA i dt 03.04.1969** banues **ne Shkozet, Durres,**madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar identifkuar nga pas Z 0828900.
**BLERESI:**
**Nikoll Gjon KOLA i dt 15.05.1967** banues ne Shkozet,Durres, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar prej pas Z 1778701 .

**Te cilet kerkuan redaktimin e kontrates me permbajtjen e meposhteme :**

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.31176 date 04.03.2004 eshte regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar**"VELLEZERIT KOLA"shpk. me ortak Z. Ndrec Kola dhe Z. Nikoll Kola me administrator Z. Nikoll Kola.** Duke u mbeshtetur ne veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit une ortaku Ndrec KOLA zoteroj ne emer te shoqerise 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit fillestar dhe te kuotave ne shumen 50.000 ( pesedhjete mije ) lek.

Ne baze te Vendimit Nr.1 date 06.01.2007 te Ortakeve te kesaj shoqerie, une Ndrec KOLA i shes 50% te kapitalit fillestar ne shumen 50.000 ( pese mije ) lek Z.Nikoll KOLA.

Z. Nikoll KOLA eshte dakord per blerjen e kapitalit ne masen 50 % ne shumen 50.000 ( pese mije ) lek te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te blere, ( 50 % ) Z. Nikoll KOLA pranon te marre persiper te gjithe detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.

***Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, shitesi Ndrec Kola nuk zoteron me asnje perqindje mne kete shoqeri dhe ortake i vetem te shoqerise"Vellezerit KOLA" behet Z.Nikoll KOLA ne masen 100%*** .

Kjo kontrate u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe duke qene e bazuar ne ligj vertetohet prej meje noterit.

**SHITESI**
Ndrec Kola

**BLERESI**
Nikoll Kola

***NOTERE***
***Ines ALEKSI***

3 B Durres
04 MARS 2004

## KERKESE

KERKUESI   Nikoll Kola administrator i shoqerise tregetare " VELLEZERIT KOLA " shpk me seli ne Durres.

OBJEKTI   Rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " VELLEZERIT KOLA " shpk ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Kerkojme rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " VELLEZERIT KOLA " shpk me dy ortake z. Nikoll Kola, Ndrec Kola. Me administrator z. Nikoll Kola, me kohezgjatje 10 vjet me seli ne Lagjen nr. 17 rruga Stef Kaculini Durres. Me kapital fillestar 100.000 leke.

Me objekt te veprimtarise se shoqerise sipas aktit te themelimit dhe statutit bashkengjitur kerkeses.

Kerkojme rregjistrimin si person juridik te shoqerise se mesiperme.

Cinaktoolet 04.03.04

KERKUESI
NIKOLL KOLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 716 Rep   Tirane, ... .03.2004

VERTETIM

Vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi per rregjistrimin si person juridik te shoqerise se mesiperme u nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesi Nikoll Kola per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti identifikues qe mbaj shtetasi e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
AFRODITA KEBER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 76 Rep

VERTETIM

Vertetohet se sot me date 3.03.2004 para meje noteres u paraqit z.Nikolla Kola banues ne Durres i cili depozitoi shumen 100.000 leke per krijimin e shoqerise tregetare " VELLEZERIT KOLA " SHPK dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

NOTER
AFRODHITA GJEBERI